




REPUBLIKA E SHQIPËRISE
GJYKATA KUSHTETUESE

Buletini periodik i Gjykatës Kushtetuese


Vendimet korrik 2024



Buletini periodik i vendimmarrjes

Nr. 4, korrik 2024

© Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë



Ky botim u mundësua me mbështetje nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Shënim: Opinonet dhe qëndrimet e paraqitura në këtë botim nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Qeverisë Zvicerane apo të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).



HYRJJE

Në kuadër të komunikimit të vazhdueshëm me publikun dhe median, të garantimit të transparencës, si dhe të rritjes së aksesit në Gjykatën Kushtetuese, si një nga parimet më të rëndësishme dhe thelbësore të administrimit të drejtësisë, Gjykata publikon Buletinin Periodik të vendimmarrjes së saj. Ai ka si qëllim informimin dhe njohjen e praktikantëve të së drejtës, studiuesve të ligjit, e çdo lexuesi, me vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese, dhe me qëndrimet e mbajtura prej saj. Kështu, botimi i sjell vendimet në mënyrë të përmbledhur dhe me një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për lexuesin. Për secilën prej tyre, paraqiten faktet që lidhen me çështjen konkrete, vlerësimi i Gjykatës lidhur me pretendimet e kërkuarit, ashtu edhe vendimmarrja e mënyra e votimit.

Në këtë numër do të gjeni të gjitha vendimet përfundimtare të dhëna gjatë periudhës korrik 2024 .

PËRMBAJTJA

Kontroll i akteve normative	4
Ankim kushtetues individual	10
Vendime të Mbledhjes së Gjyqtarëve për ankimin kushtetues individual	12

Parimi i autonomisë parlamentare - E drejta e pakicës parlamentare për të kërkuar komision hetimor - Standardi i zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese - E drejta e pakicës parlamentare për hetim efektiv – E drejta për transparencë dhe llogaridhënie - Parimi i sigurisë juridike

FJALË KYÇE

Autonomi parlamentare/ nismë ligjvënëse/ kontroll efektiv parlamentar/ hetim efektiv parlamentar/ çështje konkrete/ formulim alternativ/ boshllëk ligjor/ marrja e provave/ vendim i ndërmjetëm/ leje nga prokuroria për thirrje dëshmitarësh/ interpretim pajtues

Mungesa e parashikimit për “formulim alternativ” të objektit të hetimit krijon boshllëk ligjor që cenon të drejtën kushtetuese të pakicës dhe passjell edhe cenimin e funksionit të Kuvendit për hetim parlamentar.

Jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit (ligji ndryshues i ligjit për komisionet hetimore) – vendimi nr. 54, datë 09.07.2024

Faktet

Disa deputetë të Kuvendit depozituan disa nisma ligjore për shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, nga të cilat vetëm njëra nismë u miratua me ligjin 106/2023 në seancë plenare të Kuvendit (ligji ndryshues). Kërkuesi iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar shfuqizimin e ligjit ndryshues si të papajftueshëm me Kushtetutën, duke pretenduar, në thelb, se ligji cenon të drejtën e kontrollit të pakicës sipas nenit 77 të Kushtetutës.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata vlerësoi se edhe pse është kërkuar shfuqizimi në tërësi i ligjit ndryshues, pretendimet e tij lidhen kryesisht me nenet 4, 6, 7 dhe 9 të këtij ligji.

Neni 4 - Jurisprudenca kushtetuese thekson se e drejta për të ushtruar hetim parlamentar nuk është e pakufizuar dhe ky kufizim lidhet me detyrimin që objekti i hetimit të respektojë këto parime e standarde kushtetuese: (i) çështja duhet të ketë të bëjë me funksionin ligjvënës dhe funksione të tjera për të cilat ai është i autorizuar të marrë masa ligjore; (ii) objekti i hetimit duhet të fokusohet në çështje ose në subjekte konkrete; (iii) duhet të ekzistojnë të dhëna ose indicie të mjaftueshme që dëshmojnë për ekzistencën e një çështjeje, për të cilën është i nevojshëm hetimi, dhe (iv) kur shumica pretendon se cenohen standardet dhe parimet kushtetuese në objektin e hetimit, ajo është e detyruar të propozojë formulime alternative, duke i dhënë mundësi pakicës të riformulojë kërkesën e saj. Gjykata vërejtë se neni 4 ka reflektuar vetëm një pjesë të standardeve kushtetuese, ndërkohë që në të mungon detyrimi për shumicën parlamentare të propozojë formulime alternative kur konstaton se objekti i hetimit rrezikon standardet dhe parimet kushtetuese. Mungesa e parashikimit për “formulim alternativ” krijon boshllëk ligjor që cenon të drejtën kushtetuese të pakicës dhe passjell edhe cenimin e funksionimit të Kuvendit për hetim parlamentar.

Neni 7 (pikat 4 dhe 5) - Gjykata vlerësoi se nëse ligji nuk garanton të drejtën e marrjes së provave në aspektin procedural, ai nuk do të mund të garantojë të drejtën e pakicës për ushtrimin e kontrollit efektiv parlamentar. Për të garantuar një kontroll të tillë, vendimi i ndërmjetëm për refuzimin e provës duhet të jetë një rast përjashtimor nga rregulli i përgjithshëm, si dhe, në çdo rast, duhet të jetë i arsyetuar në drejtim të shkaqeve të refuzimit. Mënyra se si ka vepruar ligjvënësi ka krijuar boshllëk ligjor, pasi nuk ka parashikuar në nenin 7 të ligjit ndryshues garancitë e plota procedurale për të garantuar të drejtën e pakicës për kontroll efektiv parlamentar.

Neni 9 (pikat 1/2 dhe 2/4) - Gjykata vlerësoi se përmbajtja e këtyre dispozitave nuk respekton parimin e ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve dhe atë të sigurisë juridike.

Në lidhje me pikën 1/2, parashikimi që e detyron Kuvendin të kërkojë leje nga prokuroria/gjykata për thirrjen e dëshmitarëve e kufizon hetimin parlamentar për sa kohë që e lë në vlerësimin e prokurorisë/gjykatës rëndësinë dhe marrjen e kësaj prove, gjë që cenon në thelb efektivitetin e hetimit parlamentar.

(vijon në faqen 5)

Me qëllim garantimin e kontrollit efektiv parlamentar, vendimi i ndërmjetëm i komisionit hetimor për refuzimin e provës duhet të jetë një rast përjashtimor nga rregulli i përgjithshëm dhe, në çdo rast, duhet të jetë i arsyetuar.

Parashikimi që e detyron Kuvendin të kërkojë leje për thirrjen e dëshmitarëve nga prokuroria/gjykata cenon në thelb efektivitetin e hetimit parlamentar.

Neni 9 e ligjit ndryshues garanton të drejtën për të mosdeklaruar kundër vetvetes edhe për rastet kur bëhet fjalë për “persona të lidhur me të”, pa përkufizuar këtë koncept dhe pa përcaktuar kategorinë e personave që përfshihen në të. Koncepti “person i lidhur”, shkon përtej konceptit të “familjes” që mbron neni 32 i Kushtetutës, duke e bërë konceptin “person i lidhur” të paqartë.

Ky detyrim përbën një ndërhyrje në veprimtarinë e Kuvendit. Kjo dispozitë mbart probleme edhe në aspektin e qartësisë së saj, në drejtim të parimit të sigurisë juridike, pasi jo vetëm që nuk përcakton kufijtë deri ku shtrihet e drejta e prokurorit/gjykatës për lejimin e thirrjes së dëshmitarëve, por edhe në drejtim të rrethit të dëshmitarëve, e shtrin zbatimin edhe në çështje për të cilat ende nuk ka filluar hetimi apo për të cilat ende nuk është përcaktuar rrethi i dëshmitarëve që do të thirren, duke lejuar që të abuzohet me rrethin e dëshmitarëve ndaj të cilëve zbatohet kjo dispozitë. Për sa i përket përmbajtjes së pikës 2/4, duke e shqyrtuar përmbajtjen e saj në drejtim të pajtueshmërisë me të drejtat themelore të njeriut, Gjykata vlerësoi se në dallim nga neni 32 i Kushtetutës, që garanton të drejtën për të mos deklaruar kundër vetvetes ose familjes, pika 2/4 e lidh të drejtën e dëshmitarit për të refuzuar dëshminë edhe me rastet kur bëhet fjalë për “persona të lidhur me të”, pa dhënë përkufizimin e këtij koncepti dhe pa përcaktuar kategorinë e personave që përfshihen në të. Koncepti “person i lidhur”, shkon përtej konceptit të “familjes” që synon të mbrojë vetë norma kushtetuese, duke e bërë këtë dispozitë të paqartë.

Neni 6 – Gjykata vlerësoi se kjo dispozitë cenon të drejtën për transparencë dhe llogaridhënie, pasi zhvillimi i mbledhjeve me dyer të mbyllura bëhet vetëm me votat e shumicës. Gjykata vëren se në dallim me nenin e mëparshëm të ndryshuar, neni 6 ka parashikuar në mënyrë shteruese rastet ose situatat për zhvillimin e mbledhjeve pa pjesëmarrjen e publikut, duke i përcaktuar ato nëpërmjet një liste të numërtuar. Ndonëse dy shkaqet e fundit të listës (“c” dhe “d”), Gjykata i gjen të paplota dhe të paqarta, pasi lënë hapësirë për mënyrën e interpretimit të tyre gjatë zbatimit rast pas rasti nga komisioni hetimor, kjo gjithësi nuk është e mjaftueshme për ta bërë këtë nen jokushtetues, për sa kohë që ato lejojnë disa mënyra interpretimi, duke i dhënë mundësi Gjykatës që të verifikojë, përmes interpretimit pajtues, nëse ka një interpretim që është në pajtim me Kushtetutën. Në këtë aspekt, Gjykata orienton se përcaktimi “sekret tregtar” duhet të interpretohet sipas legjislacionit në fuqi, si dhe parashikimi “sekret në interes të shtetit” duhet të zbatohet dhe interpretohet nga komisioni hetimor vetëm si çdo e dhënë e parashikuar si informacion i klasifikuar në bazë të ligjit, përfshirë edhe “sekretin hetimor”. Gjykata vlerëson se me këtë interpretim pajtues, përmbajtja e nenit 6 nuk e cenon parimin e transparencës dhe të llogaridhënies.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin pjesërisht të kërkesës, konstatimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të neneve 4 dhe 7 të ligjit nr. 106/2023, shfuqizimin e nenit 9, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 106/2023, si dhe detyrimin e Kuvendit të plotësojë boshllëkun ligjor brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi (një gjyqtar u shpreh me mendim pjesërisht kundër).



Standardi i zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese - Parimi i mandatit të lirë (jodetyrues) të deputetit.

FJALË KYÇE

Veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit/ mocion për papajtueshmërinë e mandatit të deputetit/ mosmarrëveshje kompetencash midis 1/10-ës së deputetëve dhe Kuvendit/ interpretuesi i parë i normës kushtetuese/ çështje e re kushtetuese

Gjykata thekson se nga moszbatimi i një vendimi të Gjykatës Kushtetuese mund të lindë një mosmarrëveshje e re kushtetuese, në varësi të rrethanave të çështjes, e cila duhet të përmbajë elementë të rinj që nuk i janë nënshtruar më parë vlerësimit të Gjykatës.

Në vendimin 1/2023, kur trajton mosmarrëveshjen e kompetencës ndërmjet 1/10-ës dhe Kuvendit, Gjykata thekson se verifikimi dhe vlerësimi i kritereve juridiko-formale të kërkesave të kësaj natyre është një çështje që i përket Kuvendit, kurse vlerësimi i themelit të çështjes, i përket ekskluzivisht Gjykatës.

Jo më pak se një e dhjeta e deputetëve të Kuvendit dhe jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit (moszbatimi nga Kuvendi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese) – vendimi nr. 55, datë 10.07.2024

Faktet

Dy grupe prej 14 dhe 15 deputetësh të pakicës parlamentare (jo më pak se 1/10-ta) i janë drejtuar Kuvendit, në qershor dhe korrik 2022, me dy mocione, për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka, pasi shoqëria tregtare në pronësi të bashkëshortit të saj, për rrjedhojë, edhe e deputetes në fjalë, ka përfituar të drejta pasurore nga pasuri të shtetit. Kuvendi, me vendimet nr. 83 dhe nr. 84 të vitit 2022, vendosi të mos miratojë raportin e pakicës, por të miratojë raportin e shumicës parlamentare, sipas të cilit nuk plotësohen kriteret kushtetuese të Kushtetutës për të vënë në lëvizje Gjykatën (neni 70, pikat 3 dhe 4, të Kushtetutës). Për rrjedhojë, Kuvendi nuk e dërgoi çështjen në Gjykatë.

Grupi prej 1/10-ës iu drejtua Gjykatës për të zgjidhur mosmarrëveshjen e kompetencës së krijuar midis tij dhe Kuvendit, si rrjedhojë e vendimeve 83 dhe 84, si dhe deklarimin e tyre të papajtueshëm me Kushtetutën (çështja e parë). Në të njëjtën kohë, një grup tjetër prej 28 deputetësh të Kuvendit (1/5-ta), iu drejtua Gjykatës, duke kërkuar shfuqizimin e këtyre vendimeve të Kuvendit, bazuar në të njëjtët kërkitime (çështja e dytë).

Për çështjen e parë, me vendimin e saj 1/2023, Gjykata vendosi pranimin e kërkesës, zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet 1/10-ës dhe Kuvendit dhe shfuqizimin e vendimeve 83 dhe 84 të përmendur. Për çështjen e dytë, Gjykata e pushoi gjykimin me vendimin 2/2023, duke vlerësuar, në thelb, se kërkimi i saj ishte shfuqizuar me vendimin 1/2023, si dhe se Gjykata nuk kishte juridiksion për të konstatuar papajtueshmërinë e mandatit të deputetes sipas pikës 2 të nenit 70 të Kushtetutës.

Kuvendi, përmes Këshillit për Legjislacionin dhe Këshillit për Mandatet i mori sërish në shqyrtim vendimet 1/2023 dhe 2/2023. Në Këshillin për Mandatet, shumica dhe pakica paraqitën raportet e tyre në lidhje me mocionin dhe zbatimin e vendimit 1/2023 të Gjykatës, si dhe u kërkua që çështja t'i kalojë për shqyrtim seancës plenare. Kuvendi vendosi moszbatimin e vendimit 1/2023 të Gjykatës. Kërkuesit (1/10-ta dhe 1/5-ta e deputetëve) iu drejtuan Gjykatës. Kërkuesi 1/10-ta ka kërkuar deklarimin të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 41/2024 të Kuvendit dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave të krijuar nga ky vendim mes tij dhe Kuvendit, kurse kërkuesi 1/5-ta ka kërkuar interpretimin përfundimtar të neneve 70, pikat 1 dhe 4, 73, pika 1, dhe 132, pika 1, të Kushtetutës.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata konstaton se në thelb të kërkesave të 1/10-ës dhe të 1/5-ës është fuqia detyruese e vendimit 1/2023 të Gjykatës që ka përcaktuar detyrimin e Kuvendit për të iniciuar një proces kushtetues të kontrollit të papajtueshmërisë me Kushtetutën të mandatit të deputetes Olta Xhaçka. Gjykata u ndal fillimisht në trajtimin e kërkesës së 1/10-ës.

Për juridiksionin e Gjykatës - Moszbatimi i një vendimi të Gjykatës mund të lindë një mosmarrëveshje e re kushtetuese, por përcaktimi i “mosmarrëveshjes/çështjes së re” varet nga rrethanat e çështjes, në kuptimin që çështja duhet të përmbajë elementë të rinj që nuk i janë nënshtruar më parë vlerësimit të Gjykatës. Me vendimin 1/2023, Gjykata ka vendosur zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës së krijuar mes 1/10-ës dhe Kuvendit, i cili, në kundërshtim me vendimin 1/2023, sërish vendosi, me vendimin 41/2024, të mos e dërgojë në Gjykatë mocionin e 1/10-ës. Për rrjedhojë, për shkak të vendimit 41/2024, midis 1/10-ës dhe Kuvendit është krijuar një konflikt i ri kompetence. Ky konflikt është konkret, ka natyrë kushtetuese, dhe ka krijuar një çështje të re kushtetuese, e cila përfshihet në juridiksionin kushtetues.

(vijon në faqen 7)

Moszbatimi i vendimeve të Gjykatës cenon të gjithë strukturën e të drejtave dhe detyrimeve, dhe përbën një precedent të rrezikshëm.

Parimi i mandatit të lirë të deputetit nuk është liri absolute e deputetit, e pakufizuar nga Kushtetuta dhe ligjet, element i të cilave është edhe detyrueshmëria e zbatimit të vendimeve të Gjykatës.

Edhe pse Kuvendi është interpretuesi i parë i dispozitave kushtetuese, ai nuk mund të ndërhyjë për ato çështje që është shprehur Gjykata, që bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës sipas nenit 132 të saj.

Për themelin e kërkesës - Vënia në lëvizje e gjykimit kushtetues vetëm për rastin e verifikimit të papajtueshmërisë sipas pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, konsiderohet një instrument kontrolli ndaj pushtetit ligjvënës që kërkon gjykim, gjë që del jashtë tagrave dhe mundësisë të Kuvendit. Në rastet kur vihet në lëvizje, sipas nenit 70, pika 4, të Kushtetutës, Kuvendi nuk mund të vërë në diskutim mocionin e paraqitur dhe nuk mund t'ia nënshtrojë atë debatit parlamentar, por vendimarrja e tij është në funksion të legjitimitetit të këtij organi si një nga subjektet që mund të vërë në lëvizje juridiksionin kushtetues. Gjykata ritheksoi se verifikimi dhe vlerësimi i kriterëve juridiko-formale të kërkesave të kësaj natyre është një çështje që i përket Kuvendit, kurse vlerësimi i themelit të çështjes, i përket ekskluzivisht kësaj Gjykate.

Për zbatimin e vendimeve të saj, Gjykata ka theksuar se detyrueshmëria e zbatimit të vendimeve të saj garantohet nga Kushtetuta (neni 132). Ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare dhe, si të tilla, përbëjnë jurisprudencë kushtetuese, për rrjedhojë kanë efektet e forcës së ligjit. Moszbatimi i vendimeve të Gjykatës cenon të gjithë strukturën e të drejtave dhe detyrimeve të parashikuara në Kushtetutë, çka përbën një precedent të rrezikshëm.

Në lidhje me parimin e mandatit të lirë të deputetit (neni 70, pika 1, i Kushtetutës), në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se deputetit nuk i revokohet mandati nga zgjedhësit apo partia politike, ai nuk është i lidhur pas urdhrave të elektoratit dhe ai nuk detyrohet për të qenë apo mbetur pjesë e një grupi parlamentar të caktuar. Megjithatë, ky parim nuk mund të kuptohet si liri absolute e deputetit, që nuk kufizohet nga Kushtetuta dhe ligjet, për të vepruar në një mënyrë të tillë që Kuvendi të mos jetë në gjendje të zbatojë kërkesat që burojnë nga Kushtetuta dhe të miratojë vendime të papajtueshme me të. Kur deputetët thirren në votim, parimi i mandatit të lirë nuk mund të kuptohet si liri absolute e tij, që nuk kufizohet nga Kushtetuta dhe ligjet, element i të cilave është edhe detyrueshmëria e zbatimit të vendimeve të Gjykatës. Në këtë kuptim, parimi i mandatit të lirë të deputetit nuk mund të shtrihet në çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e vendimeve të Gjykatës.

Për sa i takon rolin të Kuvendit si interpretuesi i parë i normës kushtetuese, ky organ mund të ndërhyjë deri atje dhe vetëm për ato çështje që Gjykata nuk është shprehur, si organi që bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës. Nëse kjo ka ndodhur, Kuvendi nuk mund të ushtrojë më rolin e interpretuesit të parë të normës kushtetuese.

Gjykata vlerëson se vendimarrja e Kuvendit për moszbatimin e vendimit 1/2023 nuk mund të përlijet me parimin e mandatit jodetyrues të deputetit, për shkak se zbatimi i vendimit të Gjykatës nuk është një çështje politike, rast në të cilin Kuvendi ka hapësirë vlerësimi dhe deputeti gëzon lirinë e zgjedhjes së qëndrimit përmes votimit sipas mandatit të lirë.

Për kërkesën e 1/5-ës, Gjykata vlerësoi se, për sa kohë interpretimi i dispozitave kushtetuese mori përgjigje në arsyetimin e saj, nuk ndalet në shqyrtimin e saj.

Vendimarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin pjesërisht të kërkesës, zgjidhjen e konfliktit/mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Kuvendit dhe subjektit kushtetues në konflikt jo më pak se 1/10-ta e deputetëve, shfuqizimin e vendimit nr. 41/2024 të Kuvendit së Shqipërisë dhe detyrimin e Kuvendit për dërgimin në Gjykatën Kushtetuese të mocionit për papajtueshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhaçka (një gjyqtar u shpreh me mendim kundër).

Liria e veprimtarisë ekonomike - Parimi i proporcionalitetit të ndërhyrjes

FJALË KYÇE

Akcizë/ detyrime tatimore/ akcizë e diferencuar/ unifikim i akcizës/ politika ekonomike/ sistem tatimor/ trajtim preferencial

Normat juridike të shfuqizuara mund t'i nënshtrohen kontrollit kushtetues vetëm kur ato duhet të zbatohen për rregullimin e pasojave juridike që zgjasin në kohë dhe lidhen me ekzekutimin e detyrimeve juridike civile që rrjedhin nga marrëdhëniet juridike të krijuara në kohën e ligjit të shfuqizuar.

Për sa i përket kritereve që duhet të respektojnë një parashikim ligjor që sjell kufizim në lirinë e veprimtarisë ekonomike, parimi i proporcionalitetit të ndërhyrjes, analizohet sipas tre nënkritereve të tij, nevojës, domosdoshmërisë dhe përshtatshmërisë.

Për sa i përket domosdoshmërisë së ndërhyrjes vendosja e kufizimit të trajtimit preferencial, përmes unifikimit, nuk cenon thelbin e lirisë së veprimtarisë ekonomike të shoqërive anëtare të kërkuases. Mjeti i përdorur ka qenë i domosdoshëm për arritjen e qëllimit (barazi në barrën fiskale). Heqja e trajtimit preferencial të prodhuesve të birrës sjell efektin e duhur dhe realizon synimin për të cilin është përzgjedhur.

Shoqata e Prodhuesve dhe Tregtuesve të Pijeve Alkoolike Vendase (ligjet ndryshuese të ligjit për akcizat) – vendimi nr. 56, datë 16.05.2024

Faktet

Ligji për akcizat dhe ndryshimet e tij deri në vitin 2021 kishin vendosur një diferencim të akcizës për produktet e birrës në varësi të sasisë së prodhuar. Me ndryshimet ligjore të mëpasshme (ligjet nr. 81/2022 dhe nr. 94/2023), Kuvendi e shfuqizoi këtë diferencim, duke unifikuar akcizën, gjë që solli ndaj anëtarëve të shoqatës kërkuese rritjen e akcizës për produktin birrë. Kërkesja paraqiti kërkesë kushtetuese në kohë të ndryshme në Gjykatë për shfuqizimin e këtyre ligjeve ndryshuese, të cilat, sipas kërkuases, cenonin lirinë e veprimtarisë ekonomike, në drejtim të proporcionalitetit të ndërhyrjes, të drejtën e pronës, parimin e sigurisë juridike dhe nenin 70 të MSA-së.

Vlerësimi i Gjykatës

Juridiksioni i Gjykatës – Ndonëse ligji 81/2022 u shfuqizua nga ligji nr. 94/2023, ai solli pasoja të drejtpërdrejta për anëtarët e shoqatës kërkuese në drejtim të rritjes së shkallës së akcizës. Normat juridike të shfuqizuara mund t'i nënshtrohen kontrollit kushtetues vetëm kur ato, si pjesë e së drejtës pozitive, duhet të zbatohen për rregullimin e pasojave juridike që zgjasin në kohë dhe janë të lidhura me ekzekutimin periodik ose me afat të detyrimeve juridike civile që rrjedhin nga marrëdhëniet juridike të krijuara në kohën e ligjit të shfuqizuar. Në këtë kuptim, Gjykata çmoi se ka juridiksion për të shqyrtuar pajtueshmërinë e ligjit nr. 81/2022 me Kushtetutën.

Liria e veprimtarisë ekonomike – ligjet ndryshuese shfuqizuan diferencimin e akcizës, duke e unifikuar atë, që do të thotë se ndaj anëtarëve të shoqatës kërkuese do të aplikohet një detyrim i shtuar për akcizën e birrës, duke vendosur një kufizim të lirisë së veprimtarisë ekonomike. Për të vlerësuar këtë kufizim, Gjykata analizoi nëse ndërhyrja ligjore përmbushte kriteret kushtetuese sipas neneve 11 dhe 17 të Kushtetutës: (i) kufizimi të jetë bërë me ligj; (ii) për arsye/interes të rëndësishëm publik (iii) të ketë respektuar parimin e proporcionalitetit. Gjykata konstatoi se kriteri i parë është i përmbushur pasi kufizimi është bërë me ligj. Po kështu, ndryshimet ligjore i shërbejnë interesit publik, i cili konkretizohet në rritjen e të ardhurave në buxhetin e shtetit dhe përdorimin e tyre për përmirësimin e nevojave të shoqërisë, si dhe shmangien e evazionit fiskal. Për vlerësimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes, Gjykata e sheh kriterin e proporcionalitetit sipas tre nënkritereve të tij, nevojës, domosdoshmërisë dhe përshtatshmërisë. Kështu, Gjykata çmoi se ekzistonte një nevojë për ndërhyrjet ligjore, që lidhet me rritjen e të ardhurave në buxhetin e shtetit, si dhe me unifikimin e akcizës për të shmangur diskriminimin midis prodhuesve të birrës. Për sa i përket domosdoshmërisë së ndërhyrjes, Gjykata nënvizoi faktin se subjektet prodhuese dhe tregtuese të birrës kishin përfutur për një periudhë 15-vjeçare me një trajtim preferencial, me qëllim që atyre t'u jepej mundësia të përshtateshin dhe të konsolidonin aktivitetin e tyre dhe se vendosja e kufizimit të këtij trajtimi preferencial, përmes unifikimit, nuk cenonte thelbin e lirisë së veprimtarisë ekonomike të anëtarëve të kërkuases. Gjykata konstatoi se mjeti i përdorur ka qenë i domosdoshëm për arritjen e qëllimit (barazi në barrën fiskale). Së fundi, Gjykata vlerësoi se heqja e trajtimit preferencial të prodhuesve të birrës plotësonte edhe përshtatshmërinë e ndërhyrjes, pasi do të sjellë rritjen e të ardhurave në buxhetin e shtetit dhe reduktimin e hapësirave për shmangien nga pagesa e saj. Në këtë aspekt, kjo masë sjell efektin e duhur dhe realizon synimin për të cilin është përzgjedhur.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, rrëzimin e kërkesës (dy gjyqtarë u shprehën me mendim paralel dhe dy gjyqtarë u shprehën me mendim kundër).



Parimi i disponibilitetit në gjykimin kushtetues

FJALË KYÇE

Heqje dorë nga ankimi kushtetues/ përjashtim nga parimi i disponibilitetit/ interes publik/ deklarata noteriale/

Deklarata noteriale e paraqitur nga administratorët e kërkueseve, edhe pse përfaqësuesi ligjor i zgjedhur me prokurë të posaçme nuk kishte dijeni për të dhe as nuk i janë revokuar tagrat e përfaqësimit, përbën akt të heqjes dorë nga ankimi kushtetues dhe passjell pushimin e gjykimit në rast se Gjykata nuk vlerëson se shqyrtimi i çështjes ka interes publik që përjashtimisht lejon vazhdimin e gjykimit.

Shoqëria “Meteo” sh.p.k., shoqëria “NG Structures” sh.p.k. (heqje dorë nga ankimi kushtetues individual) – vendimi nr. 53, datë 08.07.2024

Faktet

Kërkueset, shoqëri me veprimtari në fushën e ndërtimit, iu drejtuan Gjykatës me ankim kushtetues individual me objekt shfuqizimin e nenit 19 të ligjit nr. 22/2018 për strehimin social, sipas të cilit 3% e sipërfaqes ndërtimore i kalon bashkisë për fondin publik të banesave sociale, pa shpërblim. Pas kalimit të çështjes në seancë plenare, administratorët e dy shoqërive kërkuese paraqitën në Gjykatë deklarata të përbashkët noteriale për heqjen dorë nga shqyrtimi i kërkesës, shkak për të cilin, Gjykata caktoi shqyrtimin me përparësi të çështjes.

Përfaqësuesi ligjor i kërkueseve për gjykimin kushtetues, i zgjedhur me prokurë të posaçme, është shprehur se deklarata nuk përbën kërkesë drejtuar Gjykatës dhe se ai nuk ka dijeni lidhur me të ose për revokimin e tagrave të përfaqësimit të kërkueseve prej tij në gjykimin kushtetues. Ndërkohë, Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë, me nismën e saj, ka paraqitur në gjykatë mendim me shkrim, duke theksuar se deklarata nuk përbën kërkesë drejtuar Gjykatës për heqjen dorë, ndaj gjykimi kushtetues duhet të vijojë, sepse çështja ka interes publik për të dhe shoqërinë në tërësi në drejtim të zhvillimit ekonomik të vendit.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata, bazuar në përmbajtjen e neneve 31/b dhe 43/b, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, vërejtë se për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues vepron parimi i disponibilitetit, sipas të cilit kërkesit i njihet e drejta që procedurën e filluar prej tij ta ndërpresë përmes aktit të heqjes dorë. Ky akt, si rregull, passjell pushimin e shqyrtimit të çështjes, me përjashtim të rastit kur shqyrtimi i saj mbart interes publik. Për rrjedhojë, Gjykata analizoi nëse (i) deklarata noteriale përbën kërkesë për heqjen dorë nga ankimi kushtetues individual; (ii) shqyrtimi i çështjes mbart interes publik, në kuptimin që të zbatohet rregulli përjashtimor i parimit të disponibilitetit.

Konkretisht, Gjykata konstatoi se nëpërmjet deklaratës noteriale, administratorët e kërkueseve u shprehën për heqjen dorë nga ankimi kushtetues individual. Duke mbajtur në konsideratë se administratori i shoqërisë, për shkak të ligjit, ka të drejtë dhe detyrohet të përfaqësojë shoqërinë dhe se vullneti për heqjen dorë është deklaruar përpara noterit publik, rezultoi se ata kanë vepruar brenda tagrave të tyre ligjore dhe nuk ka vend për të dyshuar për vullnetin e shprehur qartë prej tyre. Fakti se përfaqësuesi ligjor i shoqërive kërkuese nuk kishte dijeni për aktin e heqjes dorë ose mosrevokimin e aktit të përfaqësimit, nuk ndikon në vlefshmërinë e aktit të heqjes dorë për sa kohë bëhet fjalë për një të drejtë, që bazuar në parimin e disponibilitetit u njihet personalisht kërkueseve.

Për sa i përket interesit publik, Gjykata vlerësoi se edhe pse çështja lidhet me të drejtën e pronës dhe lirinë ekonomike të një kategori individësh, nuk është i mjaftueshëm vetëm fakti se çështja lidhet me të drejtat themelore të kërkueseve. Për rrjedhojë, për sa kohë nuk ka arsye bindëse se vazhdimi i gjykimit paraqet interes publik, nuk ka vend për të zbatuar përjashtimin nga parimi i disponibilitetit

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pushimin e gjykimit të çështjes (dy gjyqtarë u shprehën me mendim kundër).



VENDIME TË MBLEDHJES SË GJYQTARËVE PËR ANKIMIN KUSHTETUES INDIVIDUAL

**Kriteri i legjitimitit
ratione temporis për t'iu
drejtuar Gjykatës**

FJALË KYÇE

**Afati i ankimit kushtetues
individual/ marrje dijoni
efektive/ GJEDNJ/
mospranim rekursi/
moskalim i çështjes në seancë
plenare**

Si rregull, data e njoftimit është data e shpalljes së vendimit gjyqësor të arsyetuar në prani të palës, kurse kur vendimi gjyqësor nuk shpallet i arsyetuar ose kur pala nuk është e pranishme, data e marrjes dijoni konsiderohet ajo e njoftimit shkresor ose elektronik të tij. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijoni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, kur palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit.

Shoqëria “2001” sh.p.k. (paraqitje jashtë afatit e kërkesës kushtetuese) - vendimi nr. 161, datë 15.07.2024

Faktet

Kërkuesja paraqiti një kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila vendosi kthimin e saj dhe akteve pa veprim, pasi kërkuesja nuk kishte plotësuar të metat e padisë. Kërkuesja bëri ankim të veçantë. Gjykata e Apelit Tiranë vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Tiranës. Kërkuesja paraqiti rekurs. Kërkuesja, pas një periudhe disavjeçare që çështja pritej të shqyrtohej në Gjykatën e Lartë, iu drejtua GJEDN-së e cila e rrëzoi aplikimin si të papranueshëm për shkak të mosshërimit të mjetit të ankimit kushtetues. Ndërkohë që ankesa shqyrtohej në GJEDNJ, Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e rekursit me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në ligj. Më 29.04.2024, kërkuesja paraqiti ankim kushtetues individual, për të cilin Kolegji i Gjykatës Kushtetuese vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis* -Mbledhja e Gjyqtarëve konstatoi se, si datë e fillimit të afatit ligjor 4-mujor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, është data e marrjes dijoni efektivisht për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Në rastin konkret, u konstatua se vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 14.07.2021, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë më 29.04.2024, pothuajse pas 3 vjetësh, pra jashtë afatit ligjor 4-mujor. Kërkuesja ka pretenduar se është njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë, që kishte vendosur mospranimin e rekursit, nëpërmjet vendimit të GJEDNJ-së. Sipas kërkueses ajo i është drejtuar tre herë Gjykatës së Lartë në vitin 2023 për të marrë vendimin e saj të arsyetuar dhe në datën 04.01.2024, ajo Gjykatë i ka dërguar asaj vendimin e arsyetuar. Bazuar në këto fakte, Kërkuesja ka pretenduar se ka marrë dijoni efektive për vendimin e kundërshtuar në datën 04.01.2024 (vendim ky i publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së lartë më datë 29.5.2024).

Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se vendimi i GJEDNJ-së është marrë në datën 30.05.2023, ku evidentohet edhe rrethana se Gjykata e Lartë në datën 14.07.2021 kishte vendosur mospranimin e rekursit, si dhe se GJEDNJ-ja i kishte kërkuar kërkueses që të shteronte mjetin e ankimit kushtetues.

Edhe pse Gjykata e Lartë nuk e kishte publikuar në një kohë të përshtatshme vendimin e arsyetuar në faqen e saj zyrtare, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se kërkuesja kishte marrë dijoni efektive për vendimin e Gjykatës së Lartë gjatë procesit përpara GJEDNJ-së, si dhe me botimin e vendimit të kësaj të fundit në Fletoren Zyrtare në datën 27.07.2023. Në këtë situatë, konsiderohet se kërkuesja e ka paraqitur ankimin kushtetues individual tej afatit ligjor 4-mujor, për rrjedhojë ajo nuk legjitimohet *ratione temporis* për t'iu drejtuar Gjykatës.

Vendimmarrja

Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi, me shumicë votash, moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

VENDIME TË MBLEDHJES SË GJYQTARËVE PËR ANKIMIN KUSHTETUES INDIVIDUAL

**Kriteri i shterimit të
mjeteve juridike efektive**

FJALË KYÇE

**Listë-pritjeje/ nëpunës civil/
shërbim civil/ hyrje në fuqi/
fuqi prapavepruese/ vendime
përfundimtare**

**Vendimet e Gjykatës së
Lartë që prishin vendimet e
gjykatave më të ulta dhe e
kthejnë çështjen për
rigjykim nuk mund të
konsiderohen si vendime
përfundimtare, për efekt të
gjykimit kushtetues, pasi
ato nuk vendosin në mënyrë
përfundimtare për themelin
e çështjes.**

**Kur procesi i themelit
vazhdon të jetë në gjykim në
gjykata e zakonshme,
kërkuesi i ka të gjitha mjetet
e nevojshme juridike për
mbrojtjen e interesave të tij
gjatë rigjykimin të çështjes.**

Gëzim Kodra (mosshterimi i mjeteve juridike) – vendimi nr. 165, datë 17.07.2024

Faktet

Kërkuesi ushtronte detyrën e përgjegjës të sektorit në Drejtorinë e Financës në Ministrinë e Mbrojtjes. Me vendim të sekretarit të përgjithshëm të kësaj Ministrie, kërkuesi kaloi në listë-pritjeje për shkak të ristrukturimit të institucionit. Kërkuesi iu drejtua gjykatës. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë vendosi pranimin e pjeshëm të padisë. Sipas gjykatës, padia është depozituar në gjykatë në datën 20.03.2014 dhe kërkuesi është njoftuar për kalimin në listë-pritjeje në datën 19.02.2014. Me vendimin nr. 5, datë 05.02.2014, Gjykata Kushtetuese shfuqizoi aktin normativ të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 30.09.2013, që kishte përcaktuar fillimin e efekteve të ligjit të ri për nëpunësin civil. Mbi ankimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Departamentit të Administratës Publike, Gjykata Administrative e Apelit e la në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Kundër këtij vendimi u bë rekurs. Gjykata e Lartë vendosi prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim po në gjykatën e apelit, me arsyetimin se padia është paraqitur për gjykim pas hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës që shfuqizoi aktin normativ, duke mos pasur si pasojë fuqi prapavepruese në kuptim të nenit 76 të ligjit organik të Gjykatës. Gjykata e Lartë i la detyra në rigjykim gjykatës së apelit për të marrë në analizë pretendimet e parashtruara nga palët në përputhje me parashikimet e ligjit për shërbimin civil. Kërkuesi iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual.

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

Legjitimitimi i kërkuesit - Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë e cila ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë. Kërkuesi ka pretenduar se i ka shteruar mjetet juridike efektive, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë, ndonëse ka kthyer çështjen për rishqyrtim në gjykatën e apelit, është detyrues për sa u përket detyrave të lëna për këtë gjykatë.

Sipas jurisprudencës kushtetuese, vendime të këtij lloji nuk mund të konsiderohen si vendime përfundimtare, për efekt të gjykimit kushtetues, pasi ato nuk vendosin në mënyrë përfundimtare për themelin e çështjes. Në të tilla raste, kur procesi i themelit vazhdon të jetë në gjykim, kërkuesi i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tij gjatë rigjykimin të çështjes, përfshirë edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se edhe pse Gjykata e Lartë duket që e ka udhëzuar gjykatën e apelit se cili është ligji i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete, çështja e kërkuesit nuk ka përfunduar së shqyrtuari ende në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Për këtë shkak, Gjykata Kushtetuese, e cila bën gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, nuk mund të investohet në këtë fazë.

Vendimmarrja

Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi, moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

VENDIME TË MBLEDHJES SË GJYQTARËVE PËR ANKIMIN KUSHTETUES INDIVIDUAL

E drejta për t'u informuar dhe ndihmuar nga një përkthyes në gjuhën që kupton – Efektet dhe përshtatshmëria e masës së sigurimit për qëllime ekstradimi

FJALË KYÇE

Kërkim ndërkombëtar/ ekstradim/ arrest i përkohshëm/përkthyes/gjuhë që kupton/ kohëzgjatja e arsyetimit të vendimit/ mosnjoftim i arsyetimit të vendimit

Neni 28, pika 1 , i Kushtetutës shprehet për njoftimin e personit që i hiqet liria “në një gjuhë që ai kupton”, pra jo domosdoshmërisht në gjuhën e vendit, shtetësinë e të cilit ka ai person, për sa kohë që qëllimi i saj është të sigurojë njoftimin e personit të ndaluar ose të arrestuar në atë masë që është e mjaftueshme për t`i lejuar të kuptojë arsyet për heqjen e lirisë. Ligji procedural penal përcakton përkthyesin si një nga pjesëmarrësit e procedimit penal me qëllim që përmes komunikimit me të pandehurin (ose personin e barazuar me të në një proces penal) në gjuhën e tij amtare ose atë që kupton, nëse ai nuk flet dhe nuk e kupton gjuhën shqipe të procesit, ky i fundit të realizojë të drejtat e tij në procesin penal, ndër to dhe kur është rasti, edhe asaj për t`u njohur me shkaqet e arrestimit dhe për akuzën që i bëhet.

Stephan Morgenstern (masa e përkohshme e arrestit për qëllime ekstradimi) - vendimi nr. 175, datë 25.07.2024

Faktet

Kërkuesi, shtetas gjerman, është shpallur në kërkim ndërkombëtar mbi bazën e urdhrin të arrestit ndërkombëtar të lëshuar nga një gjykatë e Koresë së Jugut, e cila ka caktuar ndaj tij masën e sigurimit “Arresti në burg” si i dyshuar për kryerjen e disa veprave penale. Policia gjyqësore bëri arrestimin e përkohshëm të kërkuesit. Prokuroria i kërkoi gjykatës caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”, për efekt ekstradimi. Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë vendosi pranimin e kërkesës së prokurorit. Gjykata e apelit e la në fuqi vendimin. Kërkuesi bëri rekurs dhe Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e rekursit. Kërkuesi iu drejtua Gjykatës Kushtetuese (Gjykata).

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

Legjitimitimi *ratione materiae* -Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se pretendimet e kërkuesit lidhen me kërkesën për ekstradim, pra me themelin e çështjes, ndërkohë që objekti i procesit gjyqësor lidhet me zbatimin e përkohshëm të masave shtrënguese përpara se të vijë kërkesa për ekstradim. Për këto arsye, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se këto pretendime nuk mund të merren në shqyrtim në këtë moment, për sa kohë që kërkuesi ka ende mjete juridike efektive në dispozicion.

Për sa i përket pretendimit të kërkuesit se i është cenuar e drejta për t'u informuar dhe ndihmuar nga një përkthyes në gjuhën që kupton, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se sipas procesverbalit për arrestimin e përkohshëm, arrestimi i kërkuesit është bërë në prani të një shtetasi shqiptar, i deklaruar si person i besuar i kërkuesit, që ka pohuar se zotëronte shumë mirë gjuhën shqipe dhe atë angleze, gjuhë që e zotëronte shumë mirë edhe kërkuesi. Po kështu, në procesverbal evidentohet se arrestimi i kërkuesit bëhej për shkak se ishte në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Korea e Jugut, ndërsa gjykata e këtij vendi ka caktuar ndaj tij masën e sigurimit “Arresti në burg”. Po sipas procesverbalit, pasi është njohur me të drejtat e tij, kërkuesi ka zgjedhur mbrojtës, i cili është njoftuar menjëherë dhe ka qenë i pranishëm në veprimet ligjore në vijim. Procesverbali i arrestimit të përkohshëm është nënshkruar rregullisht dhe pa vërejtje nga kërkuesi dhe i besuari i tij. Po kështu, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se në seancën e radhës gjyqësore e pranishme ka qenë një përkthyes zyrtarë e gjuhës angleze, e cila e ka asistuar atë edhe gjatë procesit gjyqësor. Në këtë kuptim, vetëm fakti se njoftimi i shkaqeve të arrestimit dhe i akuzës që i bëhej nuk është bërë me ndihmën e një përkthyesi zyrtar, nuk mund të çojë në mohimin e faktit se ai ka marrë një njoftim të tillë, për më tepër kur nuk kontestohet saktësia e njoftimit të bërë në këtë drejtim sipas procesverbalit të arrestimit.

Për sa i përket pretendimit se masa e sigurimit ka humbur efektet e saj për shkak të mosarsyetimit të vendimit nga gjykata e shkallës së parë brenda 48 orëve, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se, sipas akteve të dosjes gjyqësore, rezultojnë që vendimi i gjykatës të jetë dhënë brenda afatit prej 48 orësh. Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkuesi nuk ka arritur të provojë pasojat e ardhura për këtë shkak, për sa kohë që ai nuk është penguar në të drejtën e tij kushtetuese për të paraqitur ankim në një gjykatë më të lartë.

Për më tepër, ligjëvënësia e ka lidhur pasojën e humbjes së fuqisë vetëm me rastin kur nuk është respektuar afati i shqyrtimit të çështjes dhe jo me rastin kur nuk është respektuar afati i arsyetimit të vendimit.

(vijon në faqen 15)

VENDIME TË MBLEDHJES SË GJYQTARËVE PËR ANKIMIN KUSHTETUES INDIVIDUAL

Masa e sigurimit nuk i humbet efektet e saj për shkak se gjykata e shkallës së parë nuk e arsyeton vendimin brenda 48 orëve. E rëndësishme është që vendimi i gjykatës të jetë dhënë brenda afatit 48 orësh. Për më tepër, ligjvënësi e ka lidhur pasojën e humbjes së fuqisë së masës vetëm me rastin kur nuk është respektuar afati i shqyrtimit të çështjes dhe jo me rastin kur nuk është respektuar afati i arsyetimit të vendimit.

Kërkuesi ka pretenduar se ndaj tij është dhënë një masë më e rëndë se ajo e kërkuar në njoftimin e Interpolit, sipas të cilit është kërkuar arresti, por jo domosdoshmërisht ai me burg, si dhe nuk është konsideruar përshtatshmëria e masave të tjera alternative, si masa e sigurimit të garancisë pasurore ose e arrestit në shtëpi. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se masa e sigurimit “Arresti në burg” është caktuar ndaj tij nga autoritetet koreane si i dyshuar për kryerjen e disa veprave penale. Në vijim, arrestimi i përkohshëm i kërkuesit nga autoritetet shqiptare dhe caktimi i masës së sigurimit arrest në shtëpi është vendosur për qëllime të ekstradimit të tij. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

Vendimmarrja

Mbledhja e Gjyqtarëve, me shumicë votash, vendosi moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

